



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 dhjetor 2017
Nr. ref.: RK 1167/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI27/17

Parashtrues

Maliq Zeqiri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurës që aplikon Departamenti
për Politika Sociale dhe të Familjes, në bazë të nenit 179 të Ligjit për
Familjen, nr. 2004/32, të 20 janarit 2006, në lidhje me adoptimin e
fëmijëve në Republikën e Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Zeqir Maliqi nga fshati Goshicë, komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston procedurën që aplikon Departamenti për Politika Sociale dhe të Familjes i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: DPSF), në bazë të nenit 179 të Ligjit për Familjen nr. 2004/32, të 20 janarit 2006 (në tekstin e mëtejme: Ligji për Familjen).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së procedurës që aplikon DPSF në bazë të nenit 179 të Ligjit për Familjen, me të cilin përcaktohen kriteret e adoptimit të fëmijëve të Republikës së Kosovës, nga shtetasit me shtetësi të Republikës së Kosovës, të cilët punojnë jashtë vendit.
4. Parashtruesi i kërkon nga Gjykata që të vërtetojë pretendimin e tij se procedura e ndjekur nga DPSF në bazë të nenit 179 të Ligjit për Familjen është e gabuar për shkak se shtetasit e Republikës së Kosovës, që aplikojnë për adoptim të fëmijës në bazë të dokumentacionit të lëshuar nga Republika e Kosovës, por që jetojnë dhe punojnë jashtë Republikës së Kosovës, po detyrohen nga DPSF t'i nënshtrohen procedurës së adoptimit të fëmijëve sikurse të ishin shtetas të huaj.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 6 mars 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 11 prill 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 20 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentacion shtesë në Gjykatë.
10. Më 13 nëntor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme, për shkak të mosplotësimit të kriterëve procedurale të kërkuara me nenin 113 të Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës punon në Qendrën për Punë Sociale (QPS) në Komunën e Vitisë. Aty, një çift bashkëshortor, shtetas të Kosovës, që punon në Itali aplikoi për adoptimin (birësimin) e një fëmije. Kërkesa e tyre për adoptimin e fëmijës ishte bërë me dokumentacion të lëshuar nga Republika e Kosovës. Më 6 prill 2017, kolegji i DPSF iu përgjigj kërkesës së tyre që: *“Rekomandohet QPS që të udhëzojë familjen që të ndjekin procedurat për adoptimin ndërkombëtar dhe të plotësojnë dokumentacionin sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.”*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“... shtetasit e Kosovës që punojnë jashtë vendit, por që paraqiten me dokumentacion vendor të Kosovës, nuk duhet t’i nënshtrohen trajtimit ndërkombëtar nga DPSF, nuk ka arsye, sepse këtë nuk e përcakton asnjë rregull ligjor. Kjo është ankesa jonë trajtimi i vendorëve me cilësi ndërkombëtare.”*
13. Përveç kësaj, parashtruesi thekson se: *“Pretendimet e Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes në Prishtinë, për vlerësimin e qytetarëve të Kosovës si ndërkombëtar është e papranueshme, dilemat janë këtu. [E lusim Gjykatën] që të merrni edhe mendimin e Departamentit për Politika Sociale dhe të Familjes dhe të vlerësoni ligjshmërinë e pretendimeve të DPSF-së. Një vlerësim i tillë, do të zgjidhte disa dilema mes punëtorëve profesionist të Qendrave për Punë Sociale në raport me Departamentin për Politika Sociale dhe Familjare të Kosovës në Prishtinë.”*
14. Për më tepër, parashtruesi kërkon *“... nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në Prishtinë, që ta pengoj Departamentin për politika sociale dhe të familjes që shtetasit vendor të mos trajtohen si ndërkombëtar vetëm pse janë jashtë vendit me punë.”*

Pranueshmëria e kërkesës

15. Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
16. Duhet bërë me dije se parashtruesi i kërkesës vepron në cilësinë e individit (personit fizik) dhe kërkesën e tij e bazon në nenin 113.7 të Kushtetutës.
17. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, që parashohin:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”
[...]

18. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu merr parasysh nenin 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

19. Përkitazi me këtë rast, Gjykata në mënyrë specifike i referohet rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë], (3) (a) të Rregullores, që përcakton:

“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

a) Gjykata nuk ka juridiksion për çështjen;
[...]

20. Gjykata thekson se neni 113 i Kushtetutës përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe palët e autorizuar që mund t'i referojnë Gjykatës pyetje të natyrës kushtetuese.
21. Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me procedurën që aplikon DPSF-ja në adoptimin e fëmijëve dhe parashtruesi i kërkesës pretendon se ky autoritet në mënyrë të gabuar po e interpreton Ligjin për Familjen, duke i trajtuar çiftet bashkëshortore vendase që punojnë jashtë vendit sikurse shtetas të huaj.
22. Gjykata specifikon se thelbi i kërkesës se parashtruesit ka të bëjë me procedurën e ndjekur nga DPSF-ja, në bazë të nenit 179 të Ligjit për Familjen, me të cilin nen rregullohet procedura e aplikimit për adoptimin e fëmijës në Republikën e Kosovës.
23. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të konfirmojë mënyrën se si e kupton dhe interpreton ai procedurën e ndjekur nga DPSF, pra si të gabuar dhe që bie në kundërshtim me vetë Ligjin për Familjen.
24. Lidhur me këtë, Gjykata rithekson se kërkesat të cilat në thelb ngrenë çështje të ligjshmërisë, dhe që kërkojnë nga Gjykata interpretim të ligjit për procedurën e ndjekur, siç është rasti konkret, si rregull, bien nën juridiksionin e gjykatave të rregullta. Në të vërtetë, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me pretendimin dhe interpretimin e parashtruesit të kërkesës se procedurat e ndjekura nga DPSF janë të gabuara dhe joligjore.
25. Gjykata mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur pretendimet për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë argumentohen në baza kushtetuese dhe bien brenda juridiksionit të saj të përcaktuar me Kushtetutë, pasi që të jenë

përmbushur të gjitha kriteret formale dhe procedurale të kërkuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore.

26. Gjykata thekson se është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
27. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe në kuadër të juridiksionit të saj kushtetues. Me fjalë të tjera, interpretimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit është në juridiksionin e gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë) (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65; shih po ashtu, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese rasti KI86/11, parashtues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
28. Andaj, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtuesit në baza kushtetuese nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, ashtu siç kërkon neni 113 i Kushtetutës dhe rregulli 36 (3) (a) i Rregullores.
29. Rrjedhimisht, në pajtim me dispozitat e sipërcekura, kërkesa e parashtuesit duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 36 (3) (a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 8 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi